



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **15 qershor 2026, (e hënë)**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**.

Kryesuesi: Fillimisht, besoj që materialin e keni pranuar me kohë! Atëherë, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, kabinetin e kryetarit, sekretarinë e kuvendit. E hapim mbledhjen e pestë (5) për këtë vit kalendarik. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-00001-0 ZK, Celinë;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e peocedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71513083-00001-0 ZK, Celinë;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret e Ndërtimit në Komunën e Rahovecit, me nr. Prot. 01 Nr. 135/26, e datës 28.4.2026;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, ky është rendi i ditës për sot me 6 pika. Nëse dikush ka diçka rreth rendit të ditës?...

Lirizon Kastrati: Faleminderit, kryesues! Të nderuar drejtorë të drejtorive, nënkryetar, anëtarë të KPF-së. Para 2 seancave janë shtyer komitetet që kemi kërkuar t'i formojmë, me arsyetimin që tashmë e din. A ka vullnet që këto komitete t'i vendosim në rend dite për seancën e radhës? Meqë jemi të pranishëm shefat e grupeve këtu, mund ta bëjmë një dakordim, që në seancën e radhës mos t'i kemi problemet e njëjta për shkak të kuotës gjinore.

Kryesuesi: Po, është e vërtetë që e kemi pasur si pikë të rendit të ditës dhe thjesht mund të themi që “kemi bërë hajgare” me themelimin e atyre komiteve dhe krejt kjo për shkak të kryeneqësisë së të gjithëve aty dhe për shkak të kuotës gjinore askush nuk donte të tërhiqej. Dokordohuni ju dhe për mua është në rregull. Në mbledhjen tjetër mund ta shohim mundësinë e themelimit të komiteve, për çka edhe zotuar në fillim. Nëse edhe dikush tjetër nuk ka ndonjë gjë rreth rendit të ditës, atëherë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Me 5 vota miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar, eventualisht ndonjë gabim?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (5) aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Harrova ta përshëndes edhe nënkryetarin. I nderuar nënkryetar, faleminderit!

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, P-71513083-00001-0 ZK, Celinë:

Behar Thaqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar i komunës, drejtorë të drejtorive, anëtarë të KPF-së. Po e paraqes propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në sipërfaqe prej 4219m². Prona në fjalë ndodhet përgjatë rrugës Rahovec-Fortesë (Paskidol), në anën e djathtë të rrugës 700m para varrezave të dëshmorëve në Fortesë. Propozohet që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 10 vjet, me qëllim të veprimtarisë bujqësore, përkatësisht për kultivimin e pemëve. Çmimi fillestar të dhënies në shfrytëzim do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

Lirigzon Kastrati: Një pyetje: kjo pronë a është në shfrytëzim tani për moment nga dikush tjetër?

Behar Thaqi: Kjo pronë është e papunuar dhe gjendet në listën e veçantë që është paraparë të jepet në shfrytëzim.

Lirigzon Kastrati: E pashë në gjeoportali dhe a kanë qasje kalimi pronat e tjera përmes kësaj prone?

Behar Thaqi: Kam qenë fizikisht atje dhe e kam parë që janë dy rrugë, pra, nuk ka pengesa.

Kryesuesi: Faleminderit! Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... A ka votë kundër?... Me 5 vota “për” miratohet pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71513083-00001-0 ZK, Celinë:

Kryesuesi: Kjo pikë lidhet me pikën e dytë dhe meqenëse emrat për këtë komisioni do të propozohen në kuvend, atëherë formalisht duhet ta votojmë këtu. Kush është “për”?... Me 5 vota “për” miratohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, drejtorë dhe ju anëtarë të KPF-së. Në mes të muajit maj ka ardhur qarkorja e parë buxhetore, në të cilën përcaktohen limitet dhe tavanet buxhetore për Komunën e Rahovecit. Brenda këtij afati kemi arritur ta përgatisim KAB-in dhe aty janë të shprehura të gjitha informatat që ndërlidhen me qarkoren buxhetore. Sipas kësaj qarkoreje, buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€. Ky buxhet ndahet në buxhet të administratës me 9.946.000, buxhet i arsimit 6.843.000, buxhet i cili ka një zvogëlim prej 660.000. Buxheti i shëndetësisë është 2.323.000. Pozicioni i pagave 12.909.000, mallra dhe shërbime 2.821.000, shpenzime komunal 440.000, subvencione janë 1.000.000 dhe investimet kapitale janë 4.523.000. Në raport me këtë buxhet, besoj që e kemi përgatitur një KAB të mirë. Në total kemi një rritje të buxhetit prej 156.000, por faktikisht në aspektin financiar nuk qëndrojmë mirë. Faktorët që kanë ndikuar që të vimë në këtë pikë janë dy: regjistrimi i popullsisë dhe njëkohësisht zvogëlimi i popullsisë, si dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve. Në raportin e vitit 2026-2027, kemi zvogëlim prej 740 nxënës. Kjo gjendje është kalkuluar në bazë të formulës në përpjesëtim nxënës-mësimdhënës dhe ka reflektuar drejtpërdrejt ulje të buxhetit. Gjithashtu, këtë vit jemi të goditur edhe nga thesari, për zbatimin e kontratës kolektive dhe nga operatorët që kanë dërguar lëndë në thesar. Deri më tani, vetëm në vitin 2026 janë tërhequr 4.5 milionë. Tani, neve na mbetet të kursejmë më shumë, të paktën t'i përfundojmë disa kontrata që konsiderojmë që janë më të ndishme. Nuk e thashë këtë, por për moment janë 205 mësimdhënës më tepër që ne duhet t'i paguajmë dhe kjo është kosto në paga mbi 2 milionë. Gjithashtu, edhe në sektorin e shëndetësisë janë rreth 50 punëtorë tepër.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Shpresoj që do të dëgjojnë këta që e hartojnë procesverbalin.

Lirigzon Kastrati: Drejtor, të falënderoj për këto informacione dhe me vetë faktin që e tregove gjendjen reale të buxhetit, KAB-in do ta përkrahim. I kam disa pyetje: The që janë 205 punëtorë tepër në arsim. Kur e kemi diskutuar në vitin e kaluar keni thënë që janë 186. Pse tani ky numër është rritur? A ka ndikuar çështja që drejtoria e Arsimit ka hapur konkurse të reja? Çështja tjetër: Te zyra e kryetarit, për çka jepen këto subvencione prej 230.000€ për çdo vit?

Afrim Limani: Lirigzon, the pse është rritur numri i arsimtarëve? Vetë zvogëlimi i numrit të nxënësve sipas formulës e ka rritur edhe numrin e arsimtarëve. Buxheti llogaritet në proporcion, nxënës-mësimdhënës dhe 1

mësimdhënës është i barabartë me 21.3 nxënës. 740 nxënës i kemi më pak në krahasim me vitin e kaluar. Në zyrën e kryetarit i kemi të buxhetuara 230.000€ dhe nga aty kryhen shumë punë: bursat, kulturë, ndihma për ndonjë sëmundje, subvencionimi i ndonjë libri etj...

Kryesuesi: Drejtor, veç një pyetje: Sa është numri i arsimtarëve tani, nëse e kalkulojmë me numrin e nxënësve?

Afrim Limani: Për moment numri është 205.

Kryesuesi: Nëse don edhe drejtori i Arsimit të flet rreth formulës?

Muhamet Morina: Përshëndetje për kryesuesin, kolegët drejtorë, anëtarët e KPF-së. E dëgjova me vëmendje drejtorin e Financave dhe ashtu është, siç e tha ai. Numri i nxënësve këtë vit është zvogëluar për 740 dhe njëkohësisht rritet numri i mësimdhënësve, sepse janë në proporcion të zhdrejtë mes vete. Është e vërtetë ajo që tha kryesuesi, sepse numri i nxënësve ka trend të zvogëlimit. Mirëpo, ne e kemi një reformë të arsimit në tavolinë që e ka filluar ish-drejtori Afrim dhe ne e kemi plotësuar dhe vazhduar. Për këtë reformë po e presim në dritë të gjelbër nga Ministria e Arsimit. Numri 205 është i llogaritur me formulë, 21.3 nxënës me 1 mësimdhënës. Këtë numër mund ta përmirësojmë vetëm te shkollat që kanë më tepër se sa një paralele. P.sh.: Te "Isa Boletini" janë 5 klasë të para dhe aty mund ta shikojmë se a po përputhet 21.3 nxënës me 1 mësimdhënës, ndërsa në shkollat e tjera që janë me nga një paralele, e kemi të pamundur ndërhyrjen. Çka nënkupton reforma që e kemi në tavolinë? P.sh.: Shkolla e Nagacit, e Polluzhës, Pastaselit, Zoqishtit etj... duhet të fuzionohen dhe të kalojnë te shkolla amë.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Dikush tjetër?... Nëse jo, po e vendosi në votim. Kush është "për"?... Me 5 vota miratohet KAB-i.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret e Ndërtimit në Komunën e Rahovecit, me nr. Prot. 01 Nr. 135/26, e datës 28.4.2026:

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Para jush e keni propozim-vendimin për shfuqizimin e rregullores për procedurat për kushtet dhe lejet ndërtimore. Me vendim të ministrisë është kërkuar që të shfuqizohet kjo rregullore, sepse sipas tyre duhet të pritet miratimi i Hartës Zonale.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A ka diskutues?... Jo! Atëherë, po e vendosi në votim. Kush është "për"?... Me 5 vota miratohet pika e pestë.

6. Të ndryshme:


Lirigzon Kastrati: Nuk e kam ndonjë diskutim të veçantë, veçse pyetja është nëse do ta realizojmë vizitën studimore në muajin gusht, vizitë kjo që është e paraparë edhe në plan të punës së kuvendit?

Kryesuesi: Do të shikojmë! Nëse eventualisht paraqitet ndonjë mundësi, atëherë po.

Berat Duraku: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, kolegë të KPF-së. E kam një kërkesë: Të na njoftoni edhe neve rreth ligjmërive që vinë nga MAPL-ja.

Kryesuesi: Po, faleminderit! Dikush tjetër?... Ju njoftoj që për seancën e rregullt të kuvendit, do t'i kemi edhe këto pika: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës, P-71510018-00428-2, ZK Dejnë; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Planit për Trashëgimi Kulturor, 2026-2029; 3. Shqyrtimi i informatës së KKSB-së për 6-mujorin e parë të vitit 2026; 4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026. Para, këto 4 shtesë dhe eventualisht nëse vjen vendimi për themelimin e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Shihemi në seancën e rregullt të kuvendit.

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi


KRYESUESI

Fatmir Iska

